



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 11.02.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Arianit Beqiri (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Rashit Gashi (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berna Saraçi (LVV), Rita Zariqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Fadil Aliu (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Liridon Selmani (PDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Arbnora Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Petrit Reçica (LVV) dhe Gëzim Mehmeti (AKR).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donjeta Sahatqiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, Donika Çeta, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Plator Gerdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të medieve. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues dhe para se të fillohet me diskutimin e pikave të rendit të ditës, **Përparim Rama**, kryetar i Komunës, para të

pranishmëve prezantoi ekipin e drejtorëve të drejtorive të Komunës dhe nënkryetarët e Komunës.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit për disa ndryshime të cilat kanë ndodhur në ndërkohë në përbërje të këshilltarëve të Kuvendit, si dhe për shkak të emërimit në pozitën e drejtorit në drejtoritë përkatëse komunale të këtyre këshilltarëve.

Lidhur me këto ndryshime tha se Fiknete Bejta ka dhënë dorëheqje nga AKR dhe i'u ka bashkangjitur GP të LDK-së, Krenar Xhaferi nga LDK, i cili zëvendësohet me Ajet Brajshorin, Izet Sadiku nga LDK, i cili zëvendësohet nga Amir Simnica, Donat Lushaku nga LDK, i cili zëvendësohet nga Dasmor Durmishi, Ilirik Musliu nga PDK, i cili zëvendësohet nga Liridon Selmani, Plator Gërdovci nga PDK, i cili zëvendësohet nga Fatmir Dervishi dhe Besianë Musmurati nga PDK, e cila zëvendësohet nga Gresa Lahu. **Kryesuesi** kërkoi nga anëtarët e rinj që të japin betimin para Kuvendit.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozoi këtë

Rend dite:

- 1.Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 2.Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2021 (TM4);**
- 3.Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2021;**
- 4.Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2022;**
- 5.Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 6.Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;**
- 7.Propozimvendimi për shfuqizimin e vendimit 01-422/01-0217897/20, të dt. 26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Prishtinës të infektuar me COVID19;**
- 8.Informatë për suksesin e nxënësve nëgjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/2022;**
- 9.Pyetje dhe përgjigje;**
- 10.Të ndryshme.**

Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Gëzim Sveçla propozoi që pika e gjashtë e rendit të ditës "Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete" të shtyhet për seancën e radhës, me arsyetimin se nuk janë përfillë procedurat e përzgjedhjes së këtyre kandidatëve dhe biografitë e të propozuarve. Kjo mënyrë e përzgjedhjes së përfaqësuesve të komuniteteve më së shumti i dëmton vet komunitetet, e dëmton rëndë edhe imazhin e organeve të Komunës, e në fund të fundit na dëmton edhe neve si këshilltarë komunal pa marr parasysh se nga çfarë subjektesh vijmë nëse e votojmë një listë të tillë. Ne mendojmë se një qasje e tillë shpërfaqë mungesë profesionalizmi dhe mungesë totale të transparencës.

Mirsad Vitia propozoi që pika e dytë e rendit të ditës “Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2021 (TM4)” dhe pika e tretë “Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2021”, të diskutohen bashkërisht, meqë TM4 është i përfshirë në raportin financiar buxhetor një vjeçar.

Sami Boroci tha se pajtohem plotësisht me parafolësin rreth çështjes së përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit për komunitete, andaj mendoj se ne nuk mundemi me votuar një përbërje të një komiteti pa i ditur emrat, pa e pasur një biografi për secilin anëtarë veq e veq. Duke pasur këtë parasysh, nuk mundem të japi votën për disa emra që servohen, që mungon biografia e tyre, e që nuk e dijnë edhe rolin e këtij komiteti. Lidhur me vërejtjet e ngritura nga parafolësit, që kishin të bëjnë me rreth procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete, sqarime shtesë dha **Betim Abdullahu**, përfaqësuesi i Zyrës për komunitete dhe kthim.

Arbër Vokri tha se duke i pasur parasysh disa fakte dhe shkresa që i kemi marrë, do të kishte me qenë mirë që mos me qenë gjithmonë vetëm një kandidatë anëtar i këtij komuniteti. Do të ishte mirë që të vendosej ndonjë rregull apo sistemi se qysh kanë me u përzgjedhur këta përfaqësues të këtij komiteti dhe për derisa të qartësohen disa çështje rreth përzgjedhjes së anëtarëve të këtij komiteti, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Bahri Gashi bëri vërejtje rreth procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit për komunitete i cili tha se a do të kishte mundësi që në këtë komitet të përfaqësohemi edhe ne si subjekt politik i AAK-së. Pse ne të tjerët mos të kemi qasje dhe mos të jemi pjesë në këtë komitet, ku është logjika.

Muhamet Selmani tha se nëse Komiteti për komunitete ka funksionuar, mendoj se ata vetëm duhet me u plotësuar ose me u ndërruar, nuk kemi nevojë me e plotësuar të tjerin.

Sipas legjislacionit thuhet se në këtë komitet duhet të jenë përfaqësues dy anëtarë të komunitetit serb, ku njëri prej tyre duhet të jetë anëtarë i Kuvendit dhe ne në fakt nuk kemi anëtarë të Kuvendit të komunitetit serb. Kjo çështje a është e rregulluar me ligj, apo mundet me u plotësuar në forma të tjera.

Jeta Rafuna - Hasani tha se në parim ne jemi dakord që të diskutohet për këtë pikë, por nuk mund të jem e sigurt se a mund të bëjmë zgjidhje për një muaj deri në seancën e radhës. Duke e pasur parasysh se ky është komision i përhershëm dhe Komuna e Prishtinës nuk besoj se duhet me mbetur pa e formuar këtë komision. Ndoshta është e rrugës që ne të procedojmë me emra të shumicës sot dhe në rindërkohë në bashkëpunim me Zyrën për komunitete të shikojmë që të bëhet plotësim ndryshimi i këtij vendimi në seancën e radhës.

Fiknete Bejta tha se Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete e kanë ligjin e veçantë dhe formulën se si themelohen, prandaj e kemi edhe Udhëzimin Administrativ të vitit 2016, dhe këtu rreth themelimit të tij nuk ka asnjë pa qartësi. Sa i përket anëtarëve të komuniteteve jo shumicë, ata nuk duhet të takojnë asnjë subjekti politik, por duhen të jeni qytetarë të thjeshtë të Prishtinës, nuk është e thënë ata me pasur ndonjë profesionalizëm por me qenë vullnetar të komuniteteve të tyre.

Leutrim Retkoceri tha se nëse procedura është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe personat të cilët janë të propozuar dhe vijnë e votohen, të mos kenë probleme me ligjin, prandaj besoj se ka mekanizma se si verifikohet dhe nuk hamendësohet se a ka pasur shkelje procedurale apo jo, dhe për përfaqësuesit e komuniteteve duhet të vendosin komunitetet vet. Propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet për votim.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dhënë nga z. Sveçla, që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për (që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës) dhe 24 vota kundër (që kjo pikë të mos shtyhet), Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete, mbetet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 5 abstenime, u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 39 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Pika e dytë dhe e tretë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2021 (TM4) dhe Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021.

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2021 (TM4) dhe Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi **Valbona Makolli**, drejtoreshë.

Mirsad Vitija, në emër të grupit parlamentar të LVV-së tha se ky dokument më së miri paraqet mos punën e ish- kryetarit Ahmeti. Në këtë raport shohim se ish- kryetari, ai flet vetëm për arkëtimet të cilat i vlerëson si të mira, por nuk i komenton shpenzimet apo të dhënat mbi investimet dhe detyrimet, mbase sepse mos puna e tij ka folur mjaft ashtu siç flet edhe sot ky raport.

Për të kuptuar se si është shpenzuar buxheti i planifikuar këtë më së miri mund ta shohim te drejtoritë komunale dhe mund të konstatojmë se prej të gjithave drejtorive komunale vetëm dy drejtori kanë arritur ta kalojnë 60% e planifikimit të buxhetit të tyre, ndërsa shumica ngelin në 50% progres. Prandaj lidhur me këtë pikë të rendit të ditës grupi ynë nuk voton fare, sepse më së tepërmi pasqyron mos punën e tij se sa arritshmëri.

Jeta Rafuna -Hasani tha se ky raport financiar pasqyron defektet kronike të ish-geverisjes komunale lidhur me shpenzimet e buxhetit për projekte kapitale.

Sipas të dhënave që i kemi përpara shohim se në vitin 2021 mjete të pa shpenzuara janë 38 milion e 220 mijë euro. Përveç të hyrave vetanake që barten kemi edhe pjesën e grandit Qeveritar që nuk mund të bartet e që realisht është shumë keq, sepse Komuna i humbë mjetet për atë vit. Po ashtu mund të konstatojmë se pothuajse në të gjitha drejtoritë vërehet realizim i ulët i buxhetit. Sipas të dhënave që janë paraqitur në këtë dokument, mund të konstatojmë se ky raport tregon edhe njëherë për një ish- qeveri të dobët komunale, jo efikase dhe të pa aftë e që fatmirësisht i'u ka përfunduar mandati. **Leutrim Retkoceri** tha se ky raport nxjerr rritje të të hyrave dhe performancë pozitive në shpenzimet buxhetore saktësisht në nën kategorinë paga dhe mallra, mëditje, shërbime dhe subvencione, por ka pasur shumë herë performancë negative në realizimin e investimeve kapitale, ku vetëm 33% e buxhetit të ndarë për këtë kategori është realizuar në vitin 2021.

Diferenca mes të hyrave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2021 përbënë suficit të pastër. Ka mbetje të mjeteve pa u realizuar janë mëse 38.3 milion euro nga ky suficit buxhetor, që buxhetit të Prishtinës i kanë humbur 3.5 milion euro që nuk kthehen nga grandit Qeveritar dhe pjesa tjetër është bartur për vitin 2022. Në realizimin e projekteve ka pasur keqplanifikim, procedura burokratike, bllokada e shumë pak ka pasur vizion dhe menaxhim në ekzekutimin e mjeteve në projekte kapitale.

Propozoj dhe ftoj të gjitha subjektet politike edhe ju subjekte opozitare që në një të ardhme të afërt të bëhemi bashkë për Prishtinën, për ti dhënë ndihmë dhe kontributin tonë së bashku me ekzekutivin në realizimin e tri instrumenteve më të rëndësishme planifikuese të buxhetit të Komunës së Prishtinës, Kornizën afatmesme të shpenzimeve, Plani zhvillimor dhe urban dhe Qarkoren buxhetore.

Endrit Zabërgja tha se duke qenë ky një raport profesional lehtë i kuptueshëm formulimi i tij nuk ka vërejtje, por përmbajtja lë për të dëshiruar. Ky raport i trashëguar mendoj se është modeli i raportit që nuk duhet të kaloj kur më nëpër duar tona.

Mos realizimi i projekteve do të thotë dështim dhe dështimi e ka gjithmonë një arsye, ku 45% i buxhetit është i definuar për investime kapitale, ndërsa investimet kapitale kanë vetëm 33.9% realizueshmëri, andaj është lehtë e nënkuptueshme që efikasiteti për ti shty projektet ka munguar dhe arsye e dështimit mbetet asgjë tjetër përveç se keqmenaxhimi.

Derisa 30% i buxhetit nuk shpenzohet investimet në zhvillimin e rinisë të ndara nga disa drejtori përfshijnë vetëm 0.3% të buxhetit, pra lidershipi i kaluar ka gjetur më shumë arsye për të investuar kudo tjetër se sa në rini, dhe prapë nuk ka mundur me i realizuar.

Duke e pasur këtë raport si argument të diskriminimit të deri tashëm të rinisë, e duke uruar që të mos përsëritet më asnjë raport i tillë, kështu që duke e kërkuar mbështetjen nga asambleja për kërkesat tona që ato ta kenë një trajtim të veçantë të ardhmen.

Muhamet Selmani tha se sa herë që është diskutuar për planifikimin e këtij buxheti dhe realizimi i tij gjithherë i kanë bërë disa vërejtje. Janë disa zëra buxhetor që janë zakonisht në planifikimin e të hyrave vetanake të Komunës që përbëjnë më shumë se 80% të planifikimit e që zakonisht nëse i shohim në raport asnjëra nuk përputhet me atë që është planifikuar, pra ose e tejkalon planifikimin ose mbeten mbrapa. Ky është

një problem që në çoftë se kaq shifra të mëdha nuk realizohen dhe nuk përputhen me planifikimin do të thotë se problemi nuk është diku tjetër përveç se te planifikuesi. Besoj se ky raport duhet të na shërbej si shembull në planifikimet e ardhshme dhe realizimet që mos të mbesin në këtë formë dhe çdo shembull i tillë është një element për tu përmirësuar në të ardhmen.

Fiknete Bejta tha se po ta analizojmë këtë raport mund të konstatojmë që ekzekutivi komplet nuk ka arritur të realizoj objektivat e saj të paraqitur në buxhetin e vitit 2020. Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të përmbush obligimet e saj të planifikuara, sidomos nuk ka arritur të përmbush planet e shpenzimeve si dhe nuk ka arritur të realizoj projektet sidomos ato të nevojshme në Komunën e Prishtinës, projektet e investimeve kapitale. Gjithashtu një shqetësim dhe një vërejtje për ekzekutivin që në të ardhmen mos të ndodh është një nivel i lartë i detyrimeve korrigjente prej 9 milion e 687 mijë euro që janë detyrime që mund të ndodhin në një kohë të afërt. Po ashtu ngecja e realizimit të buxhetit është prej tri qasjeve të qeverisë së kaluar, mungesës së vullnetit, planifikimit të keq të mungesës së stafit projektues dhe të problemeve me prokurim.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 1 kundër dhe 4 absterime, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2021 (TM4).

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 1 kundër dhe 2 absterime, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi tha se ne e kemi mbajtur një takim me grupet punuese dhe kemi pasur një bashkëpunim rreth të gjitha pikave për secilin muaj.

Gëzim Sveçla tha se ne si GP i LVV-së e përkrahim dhe do të votojmë për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit, me disa propozime që i kemi dhënë e që janë inkorporuar në këtë plan.

Jeta Rafuna -Hasani tha se edhe ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë plan vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Granit Geci, në emër të GP të PDK-së propozoi që në muajin mars të parashihet një seancë solemne me rastin e Epopes së UÇK-s, e cila do të jetë më 5 mars 2022, si njëra nga eventet më të rëndësishme për kombin tonë dhe për historinë tonë. Po ashtu do të ishte mirë që më 8 mars për Ditën e grua"ta kemi edhe një seancë tjetër solemne.

Bahri Gashi, në emër të GP të AAK-së tha se edhe ne e përkrahim për miratim Planin vjetor të punës së Kuvendit.

Sami Boroci, në emër të GP të AKR-së tha se pas një analize që i kemi bërë këtij plani, shihet se mungon harta zonale e që është premtuar dhe përfolur në qeverisjen e kaluar se kjo hartë do të vijë shumë shpejt. Lidhur me këtë kërkoi nga kryetari i Komunës se kur planifikohet që harta zonale të sillet para Kuvendit. Po ashtu tha se kur do të sillet para Kuvendit edhe Plani Zhvillimor Komunal, i cili plan është diskutuar në qeverisjen e kaluar dhe është shty për të ardhmen. Mendoj se këto dy dokumente duhet me u trajtuar sa më shpejt dhe në mënyrë sa më urgjente.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Përparim Rama**, kryetar.

Mimoza Sylejmani, drejtoreshë tha se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal, që në mandatin e kaluar kam qenë e zëshme që ky projektplan të mos të sillet në Kuvend pa plotësim dhe pa procedura të Ministrisë, e që këtë plan ende Ministria nuk e ka sjellë në Komunë.

Endrit Zabërgja tha se duke e pasur parasysh që ne nuk kemi qenë pjesë e hartimit të këtij plani të punës, dëshiroj të kontribuoj me dy propozime.

Propozoi që në mbledhjen e muajit maj të shtohet si pikë e rendit të ditës: Informim mbi gjendjen e rinisë në Komunën e Prishtinës. Po ashtu në këtë plan është dashtë të parashihet edhe trajtimi i shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari dhe nuk e shoh të renditur askund në këtë plan të punës, e që për mua reflekton një lëshim të grupit punues. Propozoi që më 28 nëntor, pas seancës solemne të paraparë, të futet përirimi i shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna nga z. Geci dhe z. Zabërgja.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, u miratuan propozimet: *"Mbajtja e mbledhjes solemne për nderë të Epopesë së UÇK-së"* dhe *"Informatë mbi gjendjen e rinisë në Komunën e Prishtinës"* propozime të cilat duhet të parashihen si pika të rendit të ditës në Planin vjetor të punës së Kuvendit.

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit duke cekur se përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa ka bërë ndryshime, ku Donat Lushaku nga subjekti politik i LDK-së ka dhënë dorëheqje pasi që është emëruar drejtor dhe tani duhet të zëvendësohet me një anëtarë nga radhët e LDK-së.

Po ashtu edhe Plator Gërdovci nga subjekti politik i PDK-së ka dhënë dorëheqje, pasi që është emëruar drejtor, dhe duhet të zëvendësohet me një anëtarë nga radhët e subjektit politik të PDK-së.

Jeta Rafuna -Hasani, për anëtarë të KPF-së propozoi Milazim Vitinë.
Shegë Beqiri - Badivuku, për anëtarë të KPF-së propozoi Leutrim Retkocerin.

Me propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e gjashtë
Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete

Jeta Rafuna -Hasani tha se sipas asaj që shihet në këtë material dy grupet parlamentare ma të mëdha kanë të drejtën të propozojnë ndonjë anëtar, pra kërkoi të dijë se a është kështu e paraparë me Udhëzim administrativ dhe me ligj, apo është çështje e shumicës së numrave në Kuvend.

Fatos Dibra, përfaqësues i Zyres ligjore tha se çështja e përfaqësimit të shumicën në këtë komitet, është çështje e shumicës së numrave në Kuvend sepse janë dy anëtarë të Kuvendit, që duhet të përfaqësohen në këtë komitet.

Gëzim Sveçla ishte i mendimit se shumica në këtë rast nënkuptohet komuniteti shumicë, prandaj nuk ka të bëjë me shumicë të asamblesë. Lidhur me këtë shtoi se nëse përcillet e njëjta logjikë si te formimi i Komitetit për Politikë e Financa, pse nuk duhet atëherë me u përcjell e njëjtë edhe për formimin e Komitetit për komunitete.

Agim Kuleta tha se vota është ajo që e përcakton e tash është çështje krejt tjetër, atëherë nëse ulemi dhe bisedojmë për ndryshe praktikisht sillen propozimet prej gjithë anëtarëve që janë këtu, pra kanë të drejt me propozuar edhe vota përcakton kush ka me qenë përfaqësues në këtë komitet.

Gëzim Sveçla, për anëtar në Komitetin për komunitete propozoi Trieria Kasumi- Berishën,
Jeta Rafuna - Hasani, për anëtar në Komitetin për komunitete propozoi Elmira Nikçi-Rexhën,

Leutrim Retkoceri, për anëtar në Komitetin për komunitete propozoi Kumrije Shabani-Ramadanin,

Sami Boroci, për anëtar në Komitetin për komunitete propozoi Gëzim Mehmetin.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna dhe konstatoi se:

Për Trieria Kosumi- Berisha ishin 13 vota për dhe 24 kundër,
Për Elmire Nikçi- Rexha ishin 26 vota për dhe 5 kundër,
Për Kumrije Shabani-Ramadani ishin 26 për dhe 2 kundër,
Për Gëzim Mehmetin ishin 6 vota për, 16 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi konstatoi se Elmire Nikçi-Rexha dhe Kumrije Shabani-Ramadani janë anëtare te reja të Komitetit për Komunitetit.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 13 kundër dhe 4 abstenime, u miratua vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete me këtë përbërje: Elmire Nikçi Rexha, Kumrije Shabani-Ramadani, Arton Brahimi, Nenad Miladinoviq, Oktaj Kurtesh, Mirsada Behluli, Faton Marolli, Adnan Ajeti dhe Kimete Shok.

Faqe 8 nga 16

Pika e shtatë

Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit 01-422/01-0217897/20, të dt. 26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19

Lidhur me Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit 01-422/01-0217897/20, të dt. 26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë e cila tha se pas një analize që e kemi bërë kemi konstatuar se është parë se është një vlerë jashtëzakonisht e madhe dhe nuk kemi mundësi ta përballojmë këtë vendim me vazhduar për ti subvencionuar qytetarët të cilt janë të infektuar me COVID.

Gëzim Sveçla tha se nëse e shfuqizojmë këtë vendim, konsideroj se është e padrejtë, kur të gjithë ne jemi dëshmitar të gjendjes së rënduar ekonomike, prandaj kisha kërkuar nga kryetari edhe nga ekzekutivi edhe nga të gjithë kolegët këtu me na përkrahur që mos me e ndërprerë këtë subvencion. Ne si grup parlamentar do të votojmë kundër këtij propozimvendimi.

Sami Boroci tha se si grup parlamentar jemi për me e shfuqizuar këtë vendim, por nëse ka vullnet prej grupeve punuese që me lënë diçka në fuqi në këtë drejtim atëherë mendoj që duhet ndoshta një kategori e rasteve sociale të subvencionohen, si kategori të caktuar. Kështu që mendoj se këtë pjesë duhet me e mbështetur edhe Drejtoria e Shëndetësisë.

Arbër Vokri tha se ndoshta trajtimi i të infektuarve me COVID ndryshon tash prej kohës paraprake dhe fatmirësisht tash numri i atyre rasteve më të rënda është zvogëluar, por edhe përkundër kësaj mendoj se qytetarët e infektuar prapë kanë nevojë për mbështetje, ndoshta duhet me modifikuar pak me i shikuar faturat ose harxhimet që i kanë pasur në ndërkohë me e bërë ndonjë selektim apo diçka tjetër.

Fisnik Osmani tha se duke parasysh disa rrethana që kanë ndikuar në mirëqenien sociale të qytetarët, si shtrejtimi i rrymës, ngritja e çmimeve, edhe ne plotësisht e përkrahim propozimin e kryetarit që të gjinden forma të tjera mbështetëse për subvencionimin e qytetarëve.

Leutrim Retkoceri tha se edhe ne e mbështesim propozimin e kryetarit për shfuqizimin e këtij vendimi, me arsyetimin se ne duhet të formojmë komisione tjera në radhë të parë për të vlerësuar gjendjen pandemike në qytetin tonë dhe pastaj me i pa format se si duhet të veprojmë më tutje. Edhe përkundër shfuqizimit të këtij vendimi, konsideroj se jemi krenar që Komuna e Prishtinës ka qenë njëra nga komunat e vetme që ka bërë mbështetje në atë kohë.

Bahri Gashi tha se grupi i asamblistëve të AAK-s është për me u vazhduar edhe më tej kjo formë e subvencionimit të qytetarëve përmes këtij vendimi.

Lidhur me vërejtjet dhe shetësimet e ngritura nga parafolësit rreth shfuqizimit të këtij vendimisqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar, Izet Sadiku, drejtor dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 18 kundër dhe 1 abstenim, u miratua vendimi për shfuqizimin e Vendimit 01-422/01-0217897/20, të dt. 26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19.

Pika e tetë

Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë të vitit shkollor 2021 - 2022

Lidhur me Informatën për suksesin e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë të vitit shkollor 2021 - 2022, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Lulzim Vrapca, përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit.

Berna Saraqi tha se në këtë dokument përfshihen edhe institucionet para shkollore, do të thotë niveli parashkollor i sistemit arsimor në Kosovë, atëhere pyes se çka ofron ky dokument përveç numrit të fëmijëve për institucion parashkollor dhe mendoj se është dashtë të na sillen më shumë të dhëna për këtë nivel të shkollimit. Fëmijët përveç se me u notuar dhe me u vlerësuar me nota, duhet shikuar se sa ata janë të zhvilluar fizikisht, sa janë të zhvilluar socialist, në çfarë gjendje psikike - fizike gjinden ata, tek e fundit si po i futin në klasë të parë apo para fillorë ata fëmijë, prandaj sugjeroj, që të fokusohemi në aspektin emocional dhe social të zhvillimit të fëmijëve. Gjithashtu kemi mungesë shumë të madhe të psikologëve, të pedagogëve të cilët do të mund ta ndihmonin këtë proces.

Sami Boroci tha se edukimi i fëmijve është njëra prej shtyllave kryesore e që duhemi me trajtuar si shtet, duhet me e trajtuar me prioritet më të lartë.

Ndër prioritetet e para do të ishte ndërtimi i shkollave, si dhe do të ishte më se e domosdoshme edhe sensibilizimi i fëmijve që ata të merren edhe me sport, pasi që mendoj se është njëfarë investimi edhe në shëndetin e tyre. Sa i përket pjesës së suksesit që na është pasqyruar në këtë dokument, mendoj se notat dhe vlerësimet në shumë raste janë jo reale dhe nuk kisha dashur me u kënaq me një vlerësim të tillë.

Ajet Brajshori tha se arsimi është në interes nacional dhe do të jetë gjithmonë në rend të parë, vërtet është interes nacional dhe kërkoj nga Komuna që të bëjë të pamundshmen të mundshme, që ta ndryshojmë thujtë në shumë fusha dhe në zhvillimin e sistemit të mirë, që pa drejtor të mirë nuk kemi edhe mësimdhënie dhe mësim nxënie pa mësimdhënës të mirë.

Po ashtu pa kushte të punës, pajisje kabinetike, laboratorike të lëndëve të ndryshme përkatëse, ku të gjitha këto janë pjesë e Komunës, si dhe mendoj se brenda këtyre viteve të kemi dhe një ndryshim në infrastrukturë në hapësirë të mjaftueshme, por edhe ndryshimin në mësimdhënie në qasje dhe në udhëheqje. Përveç udhëheqjes së shkollës të sigurojmë edhe psikolog edhe mjek dhe sociolog, pra duhet të mendojmë që shkollat tona vërtetë ti kthejmë gradualisht në gjirin e shkollave bashkëkohore në shekullin 21.

Arbër Vokri tha se sa i përket cilësisë së suksesit në arsim, mendoj se ishte dashur me pasur transparencë më të madhe kësaj radhe edhe përkujdesja për cilësi të mësimdhënies, e që ndërliket që ka pasur njerëz jo meritor. Situata me pandeminë ka

ndikuar që një pjesë të personelit mësimdhënës i kanë munguar njohurit elementare të punës me kompjuter.

Do të ishte mirë që shkollat të vizitohen nga inspektorët të cilët do ta inspektonin procesin mësimor, e që kjo do të kishte me shtuar atë përqendrimin dhe sforcimin për rritje të cilësisë në mësimdhënie. Po ashtu ndihet mungesë e kabineteve, sallave të edukatës fizike, e që do të ishte e rrugës që të ndahet një buxhet për pajisje më të mirë në shkolla.

Bahri Gashi tha se stafi i IT të Komunës ka bërë punë të madhe nëpër disa shkolla në këtë drejtim, por në disa shkolla stafi arsimor në disa raste ka pasur nevojë dhe ka bërë kërkesë prej prindërve për participim të një projektori të një kamere. Mendoj se teknologjia informative është shumë e rëndësishme për çdo shkollë, pasi që ajo e arrit edhe cilësinë e arsimit dhe vijueshmërinë.

Triera Kasumi -Berisha, lidhur me këtë raport ngriti një shqetsim e cila tha se shkollat fillore të Komunës së Prishtinës kanë fëmijë me nevoja të veçanta dhe besoj se nuk respektohen rregullore dhe procedura për vlerësimin e tyre edhe planin individual që ata realisht e kanë dhe duhet plotësuar. Besoj se këto raporte duhet me qenë shumë më specifike se sa që paraqiten dhe nuk mundemi shumë sipërfaqësisht me u marr me çështje të cilat janë shumë të rëndësishme.

Fiknete Bejta ngriti një shqetsim duke shtuar se me një vizitë të një shkolle faktikisht shumë vonë jamë njoftuar që ende personeli arsimor punon me mjet të punës me shkumës.

Lus kryetarin që në të ardhmen ta mendoj disa që me kaluar prej shkumësit në marker të paktën sepse e di që tabelat e mençura janë një kosto shumë e lartë për Komunën, por gradualisht ta avancojmë këtë çështje. Po ashtu kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që të organizoj kampanja vetëdijësuese anti bullizëm.

Lidhur me vërejtje dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit rreth informatës për suksesin e nxënësve sqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar, Valbona Makolli, drejtoreshë dhe Lulzim Vrapca, përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit.

U konstatua se u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë të vitit shkollor 2021 - 2022

**Pika e nëntë
Pyetje dhe Përgjigje**

Nora Kelmendi, për menaxhmentin e Komunës dhe për drejtorët e drejtorive të Komunës. Grupi i asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje kërkon nga menaxhmenti i Komunës dhe drejtorët që në një tabelë të na sjellë, ti përpunoj për çdo drejtori lëndët, kërkesat e qytetarëve të cilat kanë mbetur për shqyrtim. Këtë po e themi për shkak të ankesave të mëdha të cilat kanë arritur tek ne si grup parlamentar dhe do të kishte me qenë mirë që ato kërkesa apo lëndë të ndahen për secilën drejtori veçe veç.

Gëzim Sveçla, për Kryetarin e Komunës

Faqel Inga16

Z. kryetar, a mund të na tregoni se cili është programi me të cilin do të qeverisni për Prishtinën, kur do ta keni një program të tillë, a është ky programi juaj 100% me të cilin keni garuar dhe nëse mund të na thoni nga ato që i keni prezantuar për projektet kapitale, cili është projekti i parë të cilin do ta filloni dhe kur qytetarët e Prishtinës mund ta gëzojnë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Sveçla, sqarime të nevojshme dhe Përparim Rama, kryetar.

Arianit Beqiri, për Kryetarin e Komunës

Z. kryetar, një prej pikave që ju e keni pasur në programin e juaj ka qenë edhe tema Prishtina e përjetimeve, andaj dua të dijë se a do të jetë kjo Prishtina që do ta përjetojmë dhe pyetja e dytë që dua të dijë se ku jemi me aktivitetet për Manifestën, e që është tejet e rëndësishme si për qytetarët e Prishtinës por edhe për gjithë Kosovën, për shkak se po vendoset Kosova përfundimisht në hartën botërore të kulturës.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Beqiri, sqarime shtesë dhe Përparim Rama, kryetar.

Rashit Gashi, për Drejtorinë e Arsimit

Përveq që jam asamblist këtu jam edhe aktivist vullnetarë në një shoqatë për fëmijë me nevoja të veçanta konkretisht në shoqatën "Autizmi". Lidhur me këtë dua ta ngris një shqetësim, ku në këto ditë e kemi parë një fushatë denigruese madje edhe fyese thujse ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, ku si shembull mori një fëmij me nevoja të veçanta të cilit atij më se tre muaj ju pamundësua vijimi i shkollimit pa dhënë ndonjë arsye konkrete, institucioni përkatës. Kërkoj nga nga kjo drejtori që të merren masa konkrete kundër udhëheqësve të këtyre shkollave Kërkesa ime e dytë ka të bëjë me mësuesit bashkëpunues të cilët nuk po prezantojnë në shkolla dhe ka muaj të tërë që në shkollat "Faik Konica", "IsmajlQemajli" "EminDuraku", "PjetërBogdan" dhe prej këtyre shkollave kam raporte që mësuesit bashkëpunues nuk po prezantojnë, prandaj kërkoj që të merren masa të menjëhershme që ata të jenë prezentë në ato shkolla.

Po ashtu do të ishte mirë që të përshpejtësohet sa më parë procedura për punësimin e asistentëve që ky proces do të na ndihmonte shumë neve si familjar dhe si shoqatë.

Testet e shpejta që i keni dërguar nëpër shkolla të Prishtinës, do të ishte mirë që ato t'iu ofrohen edhe shoqatës së "Autizmit", pasi që ajo shoqatë nuk është në kompetencë të Komunës, ajo menaxhohet tërësisht nga ne prindërit me punën tonë vullnetare me aq sa kemi mundësi dhe donatorë të ndryshëm.

Dhurata Jahaj- Retkoceri, për Drejtorinë e Administratës

Kur do të formohet grupi i grave asambleste dhe nëse formohet a do të ketë përkrahje për aktivitete dhe kauza të grave.

Arbër Vokri, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe për Drejtorinë e Shëndetësisë

Është bërë ndoshta pak e tepërt me uzurpimin e hapësirave publike, që konsideroi se pjesa urbane e qytetit ka nis ti ngjaj një kafiterie të madhe ku nuk dihet se ku fillon e ku mbaron.

A do të kemi ndonjë ide ose ndonjë plan nëse jo së paku ta kemi atëherë vullnetin që ta bëjmë një

zgjdhje që ti lirojmë hapësirat publike dhe të ju kthehen banorëve.

Prej që jam futur në këtë Kuvend Komunal e deri në fund kam insistuar që Drejtoria e Shëndetësisë ka nevojë për më shumë ndihmë sidomos në aspektin financiar.

A do të ketë ndonjë plan për ta zgjeruar gamën e shërbimeve shëndetësore, në radhë të parë atyre diagnostike.

A mund ta shohim ndonjë plan kohor rreth fillimit të ndërtimit të Spitalit të qytetit.

Lidhur me pyetjet e ngritura nga z. Vokri, e që kishin të bënin rreth fushës së shëndetësisë, Izet Sadiku, drejtor dha sqarime të nevojshme.

Besart Krasniqi, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike

Ka diku më se dy muaj që shitësve statik ambulativ në sheshin e Prishtinës iu ka kaluar afati i lejes për ushtrimin e asaj veprimtarie dhe ende nuk ju ka vazhduar. Kërkoj që këtyre personave t'iu vazhdohet leja e punës.

Lidhur me pyetjet e ngritura nga z. Krasniqi, Përparim Rama, kryetar i Komunës dhe Valbona Makolli, drejtorshë, dhanë sqarime të mjaftueshme.

Ermal Osmani, për kryetarin e Komunës

Kur do të përfundoi restaurimi i xhamisë (afër muzeut) e cila për momentin po shfrytëzohet nga qytetarët e pandërgjegjshëm si tualet, ku dhe sipas dëshmitarëve është bërë edhe strehë e përdoruesve të substancave narkotike ose drogave të tjera.

Po ashtu shqetësuese është edhe një ndërtesë kolektive në lagjen "Ulpiana" ku ndryshimi i fasadës së saj është kryer në emër të një ndërrimi nga hapësira banesore në hapësirë afariste dhe për këtë ndryshim si dëshmi i kam edhe fotot, andaj mendoj se nuk duhet të anashkalohet një problematikë e tillë, çfarë masa do të merrni dhe kur do ti merrni.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Osmani, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.

Arianit Beqiri, për kryetarin e Komunës

A ka aplikuar LDK-ja për leje, për ndërhyrje në objektin e saj e që qytetarët mund të mendojnë që praktika e ndërtimeve pa leje ose ndërhyrja pa leje nëpër objekte po vazhdon ashtu me avazin e vjetër.

Po ashtu kërkoj të di se cila do të jetë politika të cilën do ta aplikojë Komuna e Prishtinës në aspektin e turizmit me rastin e manifestës,

A keni menduar ose a e keni pjesë të planit tuaj qeverisës për fëmijët që shesin në rrugët e Prishtinës dhe për fëmijët që kërkojnë lëmoshë në rrugët e Prishtinës.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Beqiri, Përparim Rama, kryetar dha sqarime të nevojshme.

Rita Zeqiri, për Drejtorin e Drejtorisë së Sportit dhe për Kryetarin e Komunës

Si përfaqësuese e komitetit sportiv në këtë asamble, mendoj që këtë çështje duhet ta trajtojmë në substancë dhe në thelb, në raport me problemet dhe në raport me vizionin e Prishtinës në këtë sektor. Dua ta dijë që në raport me shtyllat e cilat i keni përfshi në sport, sportin shkollor, dhe sportin elitare, pra cila prej këtyre shtyllave do të ketë prioritet sa i përket investimeve dhe vizionit tuaj.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Zeqiri, Përparim Rama, kryetar dhe sqarime të nevojshme.

Berna Saraçi, për Drejtorinë e Financave dhe për Drejtorinë e Arsimit

Në njërën prej çerdheve me bazë në komunitet, stafi punues në cilësinë e edukatoreve, kam informata se tetë prej tyre ende nuk i kanë marrë pagat për muajin dhjetor dhe janar, ndërsa pesë prej tyre nuk i kanë marrë mjetet as për muajin nëntor. Pyes: kur pritet të bëhet ekzekutimi i atij vendimi edhe pse nuk është bërë deri tani.

Lidhur me pyetjen e znj. Saraçi, Valbona Makolli drejtoreshë dhe sqarime të nevojshme.

Kumrije Shabani-Ramadani, për kryetarin e Komunës

Cilët janë hapat që i keni ndërmarrë lidhur me trajtimin e problemit të qenve endacak, deri ku ka shkuar trajtimi i tyre dhe qfar plani keni për këtë çështje.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Shabani, sqarime të nevojshme dhe Përparim Rama, kryetar.

Triera Kasumi - Berisha, për kryetarin e Komunës

Në ndërmarrjen "Spot Marketing", punëtorët e kësaj ndërmarrje nuk kanë marrë paga që 3 muaj, pyes çka po ndodhë me këtë ndërmarrje dhe çka po ndodhë me pagat e tyre.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Berisha, sqarime të nevojshme dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

Sami Boroci, ngriti një shqetësim rreth performancës së dobët që ka ndërmarrja "Sport Marketing", i cili tha se edhe në mandatin e kaluar kam ngritur këtë shqetësim se kjo ndërmarrje nuk mundet gjithnjë me mbijetuar me subvencionim nga Komuna. Përderisa kjo ndërmarrje nuk është fitimprurëse, do të jetë gjithnjë barrë e Komunës, andaj mendoj se ajo duhet të mbyllet krejt dhe ata punëtor të transferohen diku tjetër.

Lidhur me çështjen e ngritur rreth performancës së ndërmarrjes "Sport Marketing", Përparim Rama, kryetar dhe sqarime të nevojshme.

Bahri Gashi, për kryetarin e Komunës

Në parkingjet e dedikuara për parkingun e veturave, konsideroj se ka mungesë të vendeve të rezervuara për invalid dhe për persona me nevojë të veçanta. A do të kishte mundësi që kjo çështje të rregullohet që edhe invalidët dhe persona me nevojë të veçanta të kenë qasje të lehtë në ato parkingje.

Triera Kasumi – Berisha, për kryetarin e Komunës

Rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës ka disa nene të cilat janë të drejta dhe shumë të thjeshta për tu zbatuar e të cilat nuk gjejnë zbatim në terren. Përveç mos zbatimit të asaj rregulloreje në përmbajtje ka mjaft mangësi të shumë specifikave tjera të cilat vlerësoj se duhet të definohen detajisht, e të cilat realisht janë të paraqitura tepër sipërfaqësisht në këtë rregullore.

Po ashtu ndërmarrja “Prishtina Parking” rritet tërë kohën dhe e zgjeron veprimtarinë e saj nëpër lagje, rrugë të ndryshme të qytetit, ndërkohë që nuk kemi parë shpallje për vende të reja të punës e megjithatë numri i punëtorëve është rritur. Besoj se kjo temë në seancën e radhës do të ngritet si pikë e veçantë të rendit të ditës.

Lidhur me pyetjet e ngritura nga znj. berisha, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës dha sqarime të nevojshme.

Endrit Zabërgja, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike

Banorët e lagjeve “Qendra” dhe “Lakrishta” kanë bërë ankesë ndaj ndërmarrjes “Prishtina Parkingun”, të cilët kanë paguar për hapësirën e tyre, por prap aty ka probleme në veçanti të rruga “Rexhep Luci” dhe disa lokalitete tjera, ku të cilave ju është premtuar rampa dhe nuk është ndërtuar ende, kurse të lagjja “Lakrishta” ju është dhënë një afat që deri me 28 shkurt të regjistrohen ose ata do të dënohen, ndërsa banorët e lagjes kanë refuzuar të regjistrohen me arsyetimin se Ministria e ka hedhur tepër poshtë këtë vendim. Do të ishte mirë që ky shqetësim i banorëve të merret parasysh.

Ermal Osmani, për kryetarin e Komunës

Banorët e lagjes “Bregu i Diellit” janë të shqetësuar që aty pa paralajmërim është vendosur një laurë në mes të rrugës, ku dhe për këtë ka pasur protesta të banorëve dhe ndërhyrje të policisë. Por ajo që është ndoshta më irrituese e kësaj është se shefi i kësaj ndërmarrje ka pasur një qasje jo korrekte ndaj këtyre banorëve. Kërkoj nga kryetari që për këtë çështje të merr ndonjë hap konkret në zgjidhjen e këtij problemi.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Osmani, Përparim Rama kryetar dha sqarime të nevojshme.

Gëzim Sveçla tha se sa i përket ndërmarrjes “Prishtina Parking” këtë çështje duhet trajtuar mirë, pasi që veq kemi raportime nga punëtorët e kësaj ndërmarrje të cilët janë larguar nga puna për shkak të bindjeve të tyre politike, pra i kemi me emër e mbiemër. Kërkojmë nga kryetari dhe nga ju të gjithë të intervenoni në këtë drejtim që punëtorët e thjeshtë janë larguar nga puna pas përfundimit të zgjedhjeve tërësisht dhe kryesisht për motive politike nga ana e kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes.

Leutrim Retkoceri tha se do të ishte mirë që të iniciohet procedura për plotësim-ndryshimin e Rregullores për parkingun e automjeteve, që kjo rregullore në momentin që është bërë ka pas tepër pak dëgjime publike me qytetarë dhe është e panjohur për qytetarë.

Fadil Aliu tha se përderisa po diskutohet kaq shum për një rregullore të tillë, kjo tregon që me kohë nuk është përpiluar siç duhet ose për shkak të problemeve tjera që u cekën nga parafolësit. Do të ishte mirë që të bëhet plotësim- ndryshimi i saj, në mënyrë që kjo rregullore të përpilohet ashtu si duhet me standarte më të larta.

Mbledhja përfundoi në orën 16.30

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Faqe 16 nga 16

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://eee.pristina-komuna.org>